



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 139

URDHËR

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT,
PËR MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT DHE PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA
NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 19, pikave 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për hetimin administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe modelet përkatës, bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 139

RREGULLORE

**PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT, PËR MBROJTJEN
E KONFIDENCIALITETIT DHE PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA
NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**



Data: 16 Mars 2021

Nr. 139

Rregullore për hetimin administrative të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në KQZ, bazohet në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 816, datë 16.11.2016, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë dhe në referencë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe ILDKPI.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe dhënia e garancive ndaj sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- a. parandalimi dhe goditja e korrupsionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
- b. goditja e korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje;
- c. nxitja e sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit.
- d. mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës;

Neni 4

Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit;
- b. “Komisioneri” është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- c. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- d. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi;
- e. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe dispozitave të kësaj rregullore, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni;
- f. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

- g. "Korrupsion" është çdo veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, sipas legjislacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimit të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfitimit të paligjshëm të interesave, si dhe çdo akt tjetër i ngjashëm me to;
- h. "Korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje" janë çdo veprim apo mosveprime të kundraligjshme, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 328, 328/a dhe 328/b të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- i. "Mbrojtje" është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe dispozitave të kësaj rregullore;
- j. "Organizatë" është autoriteti publik ose subjekti privat.
- k. "Njësia përgjegjëse" është njësia e posaçme organizative në KQZ apo pozicioni i punës, i caktuar me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, e ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit;
- l. "Njësia përgjegjëse për korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje" është njësia e posaçme organizative në KQZ, e caktuar me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, e ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit për korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit;
- m. "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit te njësia përgjegjëse e KQZ ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni/të paligjshme, të kryera në vendin e tij të punës;
- n. "Sinjalizues" është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit KQZ, administrate zgjedhore në detyrë, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni të parashikuar në nenet 244, 244/a, 245, 312, të Kodit Zgjedhor";
- o. "sinjalizuesi i korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje" është shtetasi shqiptar me të drejtë vote i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni në zgjedhje të parashikuara në nenet 328, 328/a dhe 328/b të Kodit Penal
- p. "Subjekt privat" është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- q. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në KQZ ose jashtë tij, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

KREU II PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 5 Parimet e veprimitarisë

Njësitë Përgjegjëse në KQZ, sipas përkufizimeve të pikave "k" dhe "l" të nenit 4, për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", bazohet në parimin e:

- a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;



- b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
- c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
- d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

Neni 6

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të Njësive Përgjegjëse kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, dispozitave të kësaj rregullore dhe në rast mosparashikimi sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Njësia Përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të Njesisë Përgjegjëse të caktuar në KQZ dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Çdo punonjës i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë KQZ mund të raportojë sipas modelit 1 bashkëlidhur:
 - a) me anë të e-mailit në adresën elektronike sinjalizo@kqz.gov.al;
 - b) me zarf të mbyllur drejtuar njësisë përgjegjëse të KQZ në adresën, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 4, Tiranë.
 - c) Në portalin dedikuar kallëzimeve të cilat administrohen dhe më pas transferohen me postë elektronike të enkriptuar tek njëstë përgjegjëse të ngarkuar në këtë Rregullore.
3. Çdo zgjedhës i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, mund të raportojë sipas modelit 1/1, bashkëlidhur:
 - a) me anë të e-mailit në adresën elektronike kallzo@kqz.gov.al;
 - b) me zarf të mbyllur drejtuar njësisë përgjegjëse për korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje të KQZ në adresën, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 4, Tiranë.
 - c) Në portalin dedikuar kallëzimeve të cilat administrohen dhe më pas transferohen me postë elektronike të enkriptuar tek njëstë përgjegjëse të ngarkuar në këtë Rregullore.
4. Cdokush në administratën e KQZ-së apo Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor që vihet në dijeni të një sinjalizimi të adresuar gabimisht pranë tyre ia dërgon atë menjëherë njësisë përgjegjëse për shqyrtimin e sinjalizimeve në fushën e korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për gabimin në adresimin e çështjes dhe përgjegjësitë që i ngarkohen sinjalizuesit për këtë gabim.
5. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;

- d) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit si dhe në Kodin Zgjedhor ose akteve të tjera nënligjore të nxjera në bazë dhe për zbatim të tij, për aq sa është e mundur, të veprimeve ose praktikave që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative.
 - e) në rastin e sinjalizimit tek ILDKPKI, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm;
 - f) Në subjektin e email-it ose në zarf duhet të shënohet emërtimi “Konfidenciale”.
6. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga Njësitë Përgjegjëse si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
7. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta.
8. Dokumentacioni i plotësuar ridepozitohet pranë KQZ-së brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit të kthimit.

Neni 8

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. Njësitë Përgjegjëse të KQZ-së kanë të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:
- a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
 - c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
 - d. Sinjalizimi nga zgjedhësit nuk përmban të dhënat e identifikimit të shtetasit apo nuk ka asnjë të dhënë kontakti, sinjalizimi i tij mbyllet pa veprime të mëtejshme
 - e. Provat dhe faktet e paraqitura nga sinjalizuesi, nuk krijojnë bindjen se ka indicie të mjaftueshme për nisjen e hetimit administrativ.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ për sinjalizimet bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

KREU III

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 9

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet e brendshme regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit për regjistrimin e sinjalizimeve, i cili mbahet nga Njësia Përgjegjëse e KQZ-së sipas modelit 3, bashkëlidhur.
2. Sinjalizimet për korrupsionin aktiv ose pasiv në zgjedhje regjistrohen në një regjistër të të posaçëm protokollit ose elektronik, i cili mbahet nga Njësia Përgjegjëse për shqyrtimin e këtyre sinjalizimeve në KQZ, sipas modelit 4, bashkëlidhur.
3. Njësitë Përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 10

Parimet e hetimit administrativ nga Njësitë Përgjegjëse

1. Në kryerjen e hetimit administrativ Njësitë Përgjegjëse veprojnë:
 - a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;
 - b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
 - c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
 - d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
 - e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojtur të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
 - f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 11

Procedura e hetimit administrativ

1. Njësitë Përgjegjëse hetojnë administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë”.
2. Njësitë Përgjegjëse kanë të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime në zyrat e administratës zgjedhore ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga Njësia Përgjegjëse.
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
 - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
5. Njësia Përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Njësia Përgjegjëse është e detyruar t’i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
6. Njësitë Përgjegjëse marrin masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga Njësitë Përgjegjëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit:

- a. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për sinjalizimet e korrupsionit aktiv ose pasiv në zgjedhje sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent
- b. Njësia Përgjegjëse për sinjalizimet e brendshme, vë në dijeni eprorin e drejtpërdrejtë të sinjalizuesit; Komisionerin në rastin e sinjalizimeve ndaj funksionarëve që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 12

Provat në hetimin administrativ

1. Njësia Përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë.
2. Punonjësit e Njesisë Përgjegjëse kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Njësitë tjera të KQZ apo kushdo që ka dijeni për rrethana dhe fakte të cështjes, kanë detyrimin të vënë në dispozicion të Njesisë Përgjegjëse çdo dokumentacion që kerkohet gjatë hetimit sa më parë por maksimalisht brenda një afati 10 Ditor.
4. Në raste të veçanta, kur punonjësi/t e Njesisë Përgjegjëse vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga njësia përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Heqja e bllokimit të dokumentacionit bëhet me urdhër të njesisë përgjegjëse të KQZ për sinjalizimet e brendshme.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkon administratës zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta të bllokojnë dokumentacionin zgjedhor të administruar prej tyre. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga njësia përgjegjëse e ngarkuar me shqyrtimin e sinjalizimit të korrupsionit aktiv ose pasiv dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë.
6. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e Njësive Përgjegjëse zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
7. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e Njesisë Përgjegjëse.

Neni 13

Përfundimi i hetimit administrativ

1. Njësitë Përgjegjëse përfundojnë hetimin administrativ nëse:
 - a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, Njësitë Përgjegjëse njoftojnë me shkrim menjëherë Prokurorinë ose Policinë e Shtetit;
 - b. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.



- c. Sinjalizimi nuk provohet të ketë elementë të veprës penale apo shkeljes administrative.
2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen/ administrohen sipas rastit vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Komisioneri Shtetëror I Zgjedhjeve. Vendimi është i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.
 3. Njësia Përgjegjëse i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara të brendshme, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.
 4. Njësia përgjegjëse për shqyrtimin e sinjalizimeve të korrupsionit aktiv ose pasiv në zgjedhje, informacionin e administruar prej saj e bën pjesë të raportit vjetor në Kuvend.

KREU IV RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 14 Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia Përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
3. KQZ-ja, në komunikimet me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 15 Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU V
MBROJTJA NGA HAKMARRJA

Neni 16

Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - a) shkarkimin nga puna;
 - b) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
 - c) transferimin brenda ose jashtë organizatës;
 - d) uljen në detyrë;
 - e) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
 - f) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
 - g) mosngritjen në detyrë;
 - h) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
 - i) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
 - j) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi i brendshëm dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të KQZ, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek njësia përgjegjëse dhe një kopje e saj i dërgohet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.
4. Nëse ka vende vakante ndiqen procedurat e parashikuara nga ligji 152/2013 “Për shërbimin civil” dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij apo Kodi i Punës për të garantuar të drejtën e për tu vendosur në një strukturë tjetër të KQZ-së. KQZ merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes brenda 5 ditësh nga data e paraqitjes së saj, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, ndjek procedurat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 18 të ligjit.

Neni 17

Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje te Njësitë Përgjegjëse të KQZ-së sipas modelit 2, bashkëlidhur duke e regjistruar në regjistrin e posacëm sipa smodelit 5, bashkëlidhur.
2. Njësitë përgjegjëse marrin menjëherë masat dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendosin me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkëljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

KREU VI
AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 18

Afati i përfundimit të hetimit administrativ

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit, ose e kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të sinjalizimit.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionerit duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Neni 19

Formularët dhe regjistrat

1. Administrata e KQZ-se, përdor dhe bën të aksesueshëm online për publikun, modelin standard për sinjalizimin e brendshëm nr. 1 dhe për sinjalizimin e korrupsionit aktiv/ pasiv në zgjedhje nr. 1/1, modelin standard nr. 2 të formularit standard të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Njesitë përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e kësaj rregulloreje mirëmbajnë dhe plotësojnë në formë elektronike regjistrin e sinjalizimit të brendshëm sipas modelit nr. 3, regjistrin e sinjalizimit të korrupsionit aktiv ose pasiv në zgjedhje sipas modelit nr. 4, dhe regjistrin e mbrojtjes së sinjalizuesit nga hakmarrja në KQZ sipas modelit nr. 5, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Model 1

**FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM
"TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI"**

DREJTUAR: Njësia Përgjegjëse të caktuar në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____, paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden _____

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më /___/___, në _____ nga _____, punonjës i Njësia përgjegjëse në _____.

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Njësia përgjegjëse
1-Emër Mbiemër

FORMULAR I KALLËZIMIT/ INFORMIMIT/ DENONCIMIT/ SINJALIZIMIT TË VEPRIMEVE TË KUNDËRLIGJSHME NE ZGJEDHJE

Shkarko

Gjeneralitetet e kallëzuesit

Emër	<input type="text"/>	•
Atësi	<input type="text"/>	
Mbiemër	<input type="text"/>	•
Datëlindja	<input type="text"/>	
Vendlindja	<input type="text"/>	
Adresa:	<input type="text"/>	•
Kontakt E-Mail	<input type="text"/>	•
Telefon	<input type="text"/>	•
Nr. Personal	<input type="text"/>	

Pozicioni/ Funkzioni

Objekti i Kallëzimit (Denoncim/Sinjalizim/Informacion):

Lutemi zgjidhni objektin e kallëzimit tuaj

Financimi i partive politike/ subjekteve zgjedhore/ kandidatëve	<input type="radio"/>	Veprimtari e subjekteve zgjedhore	<input type="radio"/>
Veprimtari e komisionereve	<input type="radio"/>	Problematika në ditën e votimeve	<input type="radio"/>
Veprime të institucioneve publike në kundërshtim me Kodin Zgjedhor	<input type="radio"/>	Problematika pas ditës së votimeve	<input type="radio"/>
Korrupsion aktiv/ pasiv në zgjedhje	<input type="radio"/>	Veprimtari nga persona juridik/ fizik të ngarkuara me detyra nga KZ	<input type="radio"/>
Të papërcaktuar	<input type="radio"/>	Problem i një tjetër natyre	<input type="radio"/>

Ju lutem përshkruani shkeljen ligjore: (Plotëso jo më shumë se 500 karaktere)

Vendi ku ka ndodhur shkelja e pretenduar

Kërkon qe të mbeten anonim?

Po Jo *Vini Re: Objekti dhe rrethanat e kallëzimit tuaj do të publikohen në ndërfaqen e dedikuar për kallëzimet, ndërsa të dhënat tuaja personale do të ruhen dhe do të trajtohen në përputhje me legjislativin në fuqi.**Shpjegoni arsyet përse dori të mbeten anonim*

Dispononi provat përkatëse për t'u paraqitur bashkëlidhur këtij denoncimi/ informacioni/ sinjalizimi?

Po Jo

Përshkruani provat/ ose referencën se ku mund të gjenden provat: (Plotëso jo më shumë se 200 karaktere)

Me përdorimin e këtij portali ju bëni dakord me kushtet e përdorimit dhe privatësisë të publikuara në portal

Dergo Kallëzimin

FORMULAR I KALLËZIMIT/ INFORMIMIT/ DENONCIMIT/ SINJALIZIMIT TË VEPRIMEVE TË KUNDËRLIGJSHME

Shkarko

Gjeneralitetet e kallëzuesit

Emër	<input type="text"/>
Atësi	<input type="text"/>
Mbiemër	<input type="text"/>
Datëlindja	<input type="text"/>
Vendlindja	<input type="text"/>
Adresa:	<input type="text"/>
Kontakt E-Mail	<input type="text"/>
Telefon	<input type="text"/>
Nr. Personal	<input type="text"/>

Pozicioni/ Funkzioni

Objekti i Kallëzimit (Denoncim/Sinjalizim/Informacion):

Lutemi zgjidhni objektin e kallëzimit tuaj

Presion nga punonjes shtetëror	<input type="radio"/>	Fotografim, filmim i votes	<input type="radio"/>
Detyrim i nxenesve per te marre pjese ne	<input type="radio"/>	Votim me shume se nje here	<input type="radio"/>
Shitblerje e votes	<input type="radio"/>	Falsifikim/ shperdarje e fleteve te votimit/ materialit	<input type="radio"/>
Problem i nje natyre tjeter	<input type="radio"/>	Kanosje, dhunim, pengim	<input type="radio"/>

Paklasifikuar

Ju lutem përshkruani shkeljen ligjore: (Plotëso jo më shumë se 500 karaktere)

Vendi ku ka ndodhur shkelja e pretenduar

Kërkoni që të mbeten anonim? Po Jo

Vini Re: Objekti dhe rrethanat e kallëzimit tuaj do të publikohet në ndërfaqen e dedikuar për kallëzimet, ndërsa të dhënat tuaja personale do të ruhen dhe do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shpjegoni arsyet perse doni te mbeten anonim

Dispononi provat përkatëse për t'u paraqitur bashkëlidhur këtij denoncimi/ informacioni/ sinjalizimi?

Po Jo

Përshkruani prova/ ose referencën se ku mund të gjenden provat: (Plotëso jo më shumë se 200 karaktere)

Me përdorimin e këtij portali ju bini dakord me kushtet e përdorimit dhe privatesisë të publikuara në portal

Dergo Kallëzimin

Model 2

FORMULAR KËRKESË PËR MBROJTJE NGA HAKMARRJA
(në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit")

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____, kam paraqitur sinjalizimin në:

a) _____, pranë Njesisë përgjegjëse

b) ILDKPKI
(Bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë)

2-Për shkak të këtij sinjalizimi, pretendoj se jam subjekt i një akti hakmarrjeje të marrë ndaj meje si më poshtë:

Me _____ në

Organizatën _____

për shkak se ndaj meje është marrë masa e _____
(bashkëlidhur nëse keni akt shkresor për këtë gjë ose tregoni ku gjendet ai).

Në këto kushte mbështetur në nenin 18 dhe 19 të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" paraqes kërkesën për mbrojtjen nga akti i hakmarrjes ndaj meje, pranë;

1.Njesisë përgjegjëse në _____.

2-ILDKPKI, për shkak se;

- a) Nuk ka Njësi përgjegjëse në _____
- b) Njesia përgjegjëse nuk ka marrë masat brenda afatit ligjor 10 ditor, nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje nga sinjalizuesi.(Bashkëlidhur kërkesa për mbrojtje e paraqitur tek njësia përgjegjëse).

I-Ky formular kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, u mor në dorëzim më /___/___ nga _____, punonjës i njesisë përgjegjëse në _____

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Njësia përgjegjëse
I-Emër Mbiemër

Model - 05

Regjistri i Mbrojtjes së Sinjalizuesit nga Hakmarrja nw KQZ

Nr. Puntësi dhe Sinjalizuesit dhe	I Sinjalizuar dhe funksionat	Përshkrimi / aktit të hakmarrjes	Regjistrimi i Kartës për mbrojtje Nr. Data	Njoftimi për statusin e nevojës të kërkesës Nr. Data	Masa / Njoftimet nga Autoritet Public/Subjekt Privat	Kerkesë-pa- dritë për gjykatë Nr. Data	Përfundim
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							
16							
17							
18							
19							
20							